



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË

DICTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë
Tel & Fax: (0390) 326 657
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471
info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

Datë: **1.08.2024**

N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë në bazë të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, Neni 8 dhe 16 i shpallur në GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V/ Nr. 90/01 DHJETOR 2010, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MPMS) NR. 07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, shpallë këtë:

RISHPLLJE - KONKURS

- **Pozita e punës:** Teknik i Mirëmbajtjes Mekanike/Elektrike - Departamenti i Prodhimit - 2 pozita
- **Kohëzgjatja e punës:** 6 (gjashtë) muaj me mundësi vazhdimi
- **Paga bazë:** Në bazë të rregullores së brendshme

Detyrat, përgjegjësitë dhe autoritetet:

- Të angazhohet gjatë realizimit të punimeve në impiantin e Kogjenerimit,
- Merr pjesë në trajnimet e organizuara për punën e kaldajave dhe sistemit SCADA,
- Asiston teknikët dhe elektrikistin gjatë punës së tyre të përditshme sipas orarit të caktuar,
- Përgatitet për të marrë përgjegjësitë pas zbatimit të projektit të Kogjenerimit,
- Për punën e tij drejtpërdrejt i përgjigjet udhëheqësit të Prodhimit.

Kualifikimi dhe aftësitë: (Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim)

- CV
- Aplikacioni që merret ne WEB-faqe ose me rastin e dorëzimit të dokumentacionit,
- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme (teknike),
- Vërtetim mbi përvojën në punë si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe eksperiencës,
- Përvojë së paku 2 vjeçare profesionale,
- Certifikata që nuk është nën hetime për ndonjë vepër penale (jo më e vjetër se 6 muaj).

Kërkesat shtesë:

- Të ketë aftësi dhe të jetë bashkëpunëtor i mirë,
- Të jetë person me integritet dhe besueshmëri në punë,
- E preferueshme përvoja e punës e mëhershme në ndërmarrje-kompani që zhvillojnë aktivitete të ngjashme,
- Të posedojë dëshmi të trajnimeve profesionale (e preferueshme).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, përkatësisht prej datës **01.08.2024 – 15.08.2024** në **16.00h**.

Testimi dhe intervistat mbahen në lokalet e ndërmarrjes pas përfundimit të afatit të konkursit.

Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen me shkrim përmes E-mail dhe nr. të telefonit.

Dokumentacionet e kompletuara dorëzohen në N.P “Ngrohtorja e Qytetit” SH.A Gjakovë, rr. “Behije Dashi”, pn Rezinë, ose nëpërmjet postës.

VËREJTJE: Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të konkursit do të anulohen dhe nuk do të shqyrtohen.